

LIGJ
Nr.8377, datë 22.7.1998

**PËR SHPALLJEN E MORATORIUMIT PËR DETYRIMET E PASHLYERA TË ISH-
NDËRMARRJEVE TË TREGTISË SË JASHTME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
KUNDREJT KREDITOREVE TË HUAJ**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Shpallet moratoriumi për të gjitha detyrimet e pashlyera të ish-ndërmarrjeve të tregtisë së jashtme, të lindura deri më 31 dhjetor 1992, kundrejt kreditorëve të huaj.

Organet shtetërore dhe institucionet, që kanë të drejta mbi detyrimet e mësipërme, nuk mund të kryejnë asnjë veprim për pagesën e tyre.

Të, gjitha çështjet civile që janë në shqyrtim, në çdo hallkë gjyqësore, si dhe vendimet gjyqësore që kanë marrë formë të prerë ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pezullohen.

Personat e interesuar kanë të drejtë të paraqesin padinë për kërkimin e detyrimeve, të cilat do të regjistrohen nga gjykata për efekt të parashkrimit të padisë, që ndërpritet në bazë të nenit 131 të Kodit Civil.

Neni 2

Detyrimet që i nënshtrohen moratoriumit do të shlyhen sipas kriterëve që do të përcaktohen me ligj të veçantë.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2172, datë 28.7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani